



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**



**UNIVERSITETI
BARLETI**

FTESË PËR PJESËMARRJE

**DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE
ORGANIZON**

KONFERENCËN E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI,

ME TEME:

**“LIGJËRIMI I SHKRUAR DHE I FOLUR, PROBLEME REALE DHE
PROPOZIME KONKRETE PËR ZGJIDHJEN E TYRE”**

05 MAJ, 2023

Kampusi 1- Spitallë, ora 11:00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

PËRSHËNDETJE,

Më datë 05.05. 2023, Departamenti i Gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Edukimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ka nderin dhe kënaqësinë t’Ju ftojë të merrni pjesë në Konferencën e parë shkencore ndërkombëtare të gjuhësisë me temë: ***“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete per zgjidhjen e tyre”***.

Konferenca ka për qëllim të mbledhë rreth vetes akademikë, profesorë, kërkues shkencorë dhe studiues të fushës së gjuhësisë (duke mos përjashtuar edhe ato të fushave të tjera), me qëllim që përmes ideve, mendimeve, metodave konkrete e strategjive të ndryshme, të kontribuohet në zgjidhjen e problemeve reale që lidhen me ligjërimin, si në aspektin e njohjes së njohurive gjuhësore, ashtu edhe në aspektin e zotërimit të aftësive praktike dhe përmirësimin e kapacitetit ligjërimor në përdorim.

Me anë të kësaj konference synohet në veçanti të vihen në dukje probleme reale të gjuhës së shkruar shqipe dhe asaj të folur, si dhe probleme që lidhen me përdorime gjuhësore në të gjitha fushat e veprimtarisë tonë të përditshme; probleme që lidhen me stilet e përdorimit, me regjistrat gjuhësorë në të folur e në të shkruar...etj.

Variacioni i larmishëm gjuhësor tregon vlerën e padiskutueshme të gjuhës njerëzore, si dhe fuqinë e saj të pashmangshme në çdo kohë. Për rrjedhojë, misioni i konferencës lidhet mbi të gjitha me punën që duhet bërë për një përdorim sa më të suksesshëm të aftësisë sonë gjuhësore me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencës ligjërimore si pjesë e qenësishme e sjelljes sonë njerëzore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

TEMATIKA

1. Probleme reale të gjuhës së sotme shqipe dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre

- *Gjuha standarde shqipe dhe edukimi gjuhësor*
- *Strategjitë dhe politikat arsimore në fushën e edukimit gjuhësor*
- *Integrimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës shqipe*
- *Variacioni gjuhësor dhe kujdesi ndaj gjuhës së shkruar shqipe*
- *Variacioni funksional i gjuhës shqipe*
- *Përshatja e terminologjisë së fushës së teknologjisë së informacionit me gjuhën standarde shqipe.*
- *Variacioni gjeografik i gjuhës shqipe*
- *Roli i dialekteve në pasurimin e gjuhës standarde shqipe*
- *Variacioni historik i gjuhës shqipe*
- *Studimet letrare dhe gjuha shqipe*
- *Rëndësia e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në fushën e drejtësisë*

2. Ligjërimi i shkruar dhe i folur në kuadër të zhvillimit global

- *Fuqia e gjuhës përmes aftësisë dhe kapacitetit në ligjërimin e shkruar dhe atë të folur*
- *Rëndësia e bilinguizmit (a multilinguizmit) gjuhësor dhe shmangia e pasojave.*
- *Roli i ligjërimin në sjelljen tonë njerëzore*
- *Aspekte konjitive në zhvillimin gjuhësor të fëmijës*
- *Gjuhësia e zbatuar dhe mësimi i gjuhëve të huaja*
- *Gjuha, komunikimi dhe biznesi*
- *Gjuha, komunikimi dhe industria e turizmit*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

NJOFTIME TË RËNDËSISHME

Gjuha e konferencës: SHQIP dhe ANGLISHT;

Dorëzimi i abstraktit: deri më ~~01.03.2023~~; 26. 03. 2023

Programi i konferencës: ~~31.03.2023~~; 05. 04. 2023

Dita e zhvillimit të konferencës: 05. 05. 2023

Tarifa e konferencës:

Për çdo pjesëmarrës konferenca është **PA PAGESË**, porse “konferenca,, nuk mund të mbulojë shpenzime të tjera për pjesëmarrësit si, udhëtimin, fjetjen...etj. Njoftime të mëtejshme për botimin e punimeve të plota (ISBN ose ISSN) do t’u dërgohen të gjithë pjesëmarrësve me “e-mail,,

Të dhëna për dërgimin e abstraktit:

- Abstraktet e punimeve duhet të dërgohen në adresën:
konferencadgjsh@gmail.com
- Abstrakti duhet të jetë në formatin “Word”, me jo më shumë se **300 fjalë**.
Për pranimin e abstraktit do të njoftoheni më **05. 04. 2023**

Abstrakti duhet të përfshijë:

- **Titullin e kumtesës** (të theksuar, të qendëruar, me shkrim “Times New Roman”, madhësia 14);
- **Emrin e autorit** (titullin e tij shkencor, institucionin ku është i punësuar, adresa e “e-mail”-it, madhësia 11);
- **Tekstin** (shkrimi i përdorur: “Times New Roman”, madhësia 12, “margjina” normale, hapësira “single”)
- **Fjalët kyçe** (maksimalisht 5, madhësia 11, me shkrim të pjerrët).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

Detajet e kontaktit:

Për çdo pyetje mund të shkruani në adresën:

konferencadgsh@gmail.com

Ju mirëpresim në Durrës më, 05 maj 2023!